



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1312/2 prot.

Tiranë, më 21. 10. 2025

V E N D I M

Nr. 241, datë 21. 10. 2025

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 195 Regj., datë 15.09.2025, të z. A. B. A., kundër subjektit D... Boutique Hotel, me pretendimin e diskriminimit për shkak të racës.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet e depozituara nga subjekti ankues, z. A. B. A., parashtron ndër të tjera në ankesë se: “...Kam punuar në hotel që nga muaji shkurt dhe i jam përkushtuar punës sime, çdokush që punon aty mund ta dëshmojë këtë. Kisha një marrëdhënie të mirë me pronarin e hotelit deri sa mori detyrën menaxheri, dhe që prej asaj kohe ai vazhdimisht më ka folur dhe ka treguar mungesë respekti ndaj meje, pothuajse gjatë gjithë kohës. Unë u ankova te R.... për shkak të respektit që kemi për njëritjetrin, dhe ai më kërkoi të qëndroja, gjë që bëra përpara se të kisha problemin e fundit me menaxherin, të cilin besova se u përpoqa ta trajtoja sa më mirë që munda...”

Ai më thirri sërish të nesërmen në mëngjes dhe më foli ashpër, dhe unë vendosa të largohesha nga puna, por ai më kërkoi të vijoja punën. Çfarë donte të thoshte me këtë, a jam unë skllav apo nuk kam të drejtë, dhe nëse nuk jam skllav, pse do të më thoshte një gjë të tillë, pasi në vend që të më linte të largohesha, më kërcënoi se do të më gjente, si dhe mu drejtua me fjalë fyese.

Kam punuar muajin e kaluar 12 orë në ditë për 500 euro dhe këtë muaj kam punuar 2 javë. Java e parë 12 orë, përpara se të vinte stafi i ri. Gjithçka që po kërkoj është drejtësi dhe pagesën e plotë, sepse kam fatura për të paguar dhe kam qëndruar pa para dhe pa u ushqyer siç duhet për gati një javë e gjysmë. Për hir të së vërtetës, pronari ka qenë shumë i sjellshëm me mua, por menaxheri i ri na trajtonte, mua dhe stafin si mbeturina....”.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

Sakaq, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminim e tij për shkak të racës dhe të marrë pagesën³ e plotë për periudhën e fundit që ka punuar pranë subjektit D... Boutique Hotel.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Bazuar në nenin 7 të LMD-së, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjese në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, më datë 24.09.2025, inspektori i çështjes, mori kontakt përmes telefonit me drejtuesin e subjektit D... Boutique Hotel, për tu informuar sa i përket ankesës së paraqitur nga ana e z. A. B. A. Nga biseda telefonike me administratorin e D... Boutique Hotel, inspektori i çështjes u informua nga ana e tij se në ditët në vijim, ai do të shlyente të gjitha detyrimet e mbetura ndaj subjektit ankues, duke plotësuar kështu edhe kërkesat e tij të paraqitura përpara Komisionerit.

Subjektit ankues, në vijim më datë 13.10.2025 është paraqitur pranë Zyrës së KMD-së, ku ka konfirmuar faktin janë shlyer të gjitha detyrimet e prapambetura dhe ka filluar punë sërish pranë D... Boutique Hotel, pas komunikimit që inspektori i çështjes pati me punëdhënësin e tij. Për këtë

³ Subjekti ankues referon në ankesë se kërkon të marrë pagesën e muajit të fundit që ka punuar 12 orë dhe pagesën e 2 javëve përpara se të largohet nga puna.

arsye, subjekti ankues kërkoi⁴ nga Komisioneri të tërhiqet nga ankesa e bërë kundër subjektit, D... Boutique Hotel.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, kërkimi i palës ankuese, ose ajo që pala ankuese kërkon të arrijë ose të sigurojë, nëpërmjet paraqitjes së ankesës objekt shqyrtimi (me nr. 195 regj./2025) dhe fillimit të kësaj procedure administrative është përmbushur, nëpërmjet shlyerjes së detyrimeve të prapambetura ndaj z. A. B. A. nga ana e subjektit D... Boutique Hotel.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94⁵/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb, pasi u zgjidh problematika e adresuar pranë Komisionerit.

Për rrjedhojë është përmbushur edhe qëllimi i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për sigurimin e të drejtës së çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës individuale, të paraqitur nga subjekti ankues, z. A. B. A., i cili, me anë të kërkesës së mbajtur me Procesverbalin nr. 1312/1 prot., datë 13.10.2025, është tërhequr nga ankesa e tij pranë KMD-së.

⁴ Përmes Procesverbalit të mbajtur nr. 1312/1 prot., datë 13.10.2025.

⁵ “Tërheqja e ankesës”.

Përfundimisht, referuar sa më sipër, si dhe duke mbajtur në konsideratë:

- Masat efektive konkrete të ndërmarra nga ana e subjektit D... Boutique Hotel, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe rimarrjen në punë të subjektit ankues.
- Përmbushjen e qëllimit për të cilin ishte iniciuar ankesa konkrete, si dhe
- Qëllimin parandalues të LMD-së, ndërgjegjësimin e ndërmjetësimit për zgjidhje miqësore e zbatim efektiv të tij, dhe jo vetëm karakterin konstatues dhe ndëshkues të vendimarrjeve të KMD-së;

Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 195 regjistri, datë 15.09.2025, të paraqitur nga z. A. B. A., duhet të deklarohej e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, për sa kohë që objekti dhe qëllimi që pala ankuese ka kërkuar të realizojë nëpërmjet kësaj procedure administrative është përmbushur⁶.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 195 Regj., datë 15.09.2025, të paraqitur nga z. A. B. A., pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Raca)
(Fusha: Punësim)

⁶ Për analogji citojmë vendimet e KMD-së: Nr. 107/2024, Nr. 181/2024, Nr. 2, datë 06.01.2025.